



9/41-V2

Statut i Organizatës Studentore

Maj/2019

**S T A T U T
TË ORGANIZATËS TË STUDENTËVE**

PRISHTINË, Maj 2019

Mbështetur në dispozitat e neneve respektive të LIGJIT Nr. 04/L-037 PËR ARSIMIN E LARTË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS, si dhe dispozitës së nenit 88 të Statutit të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, Organizata e Studentëve të këtij Kolegji, në mbledhjen mbajtur në Prishtinë më datën **15.05.2019**, kanë miratuar këtë:

S T A T U T TË ORGANIZATËS TË STUDENTËVE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1.

Më këtë Statut më përafërte rregullohen sidomos:

- *statusi dhe pozita e Organizatës së Studentëve BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë,*
- *emri, vendi dhe qëllimet programore të Organizatës së Studentëve,*
- *anëtarësimin në Organizatës së Studentëve,*
- *të drejtat dhe detyrimet e përgjegjësitë të anëtarëve të Organizatës së Studentëve,*
- *mënyra e organizimit,*
- *zgjedhja e organeve dhe shkarkimi i tyre,*
- *zgjatja e afateve të mandateve dhe mënyrë e vendosjes,*
- *puna publike,*
- *lidhja me Organizatave të Studentëve të subjekteve e tjerë, organizata dhe institucione,*
- *procedura e nxjerrës së Statutit dhe akteve tjera normative, si dhe ndryshim plotësimet e tyre, dhe*
- *çështje dhe pyetje tjera me rëndësi për Organizatën e Studentëve.*

Neni 2.

Selia e Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, është në **PRISHTINË, Lagja "KALABRIA", Rr. Rexhep Krasniqi, nr. 56**, dhe përmbushë veprimtarin e sajë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, si dhe bashkëpunon me organizatatë simotra të studentëve dhe institucionet tjera ne Republikën e Kosovës - dhe jashtë sajë.

Neni 3.

Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, është **organizatë studentore joqeveritare, jofitimprurëse dhe jashtë partiake**, dhe e cila përfshinë studentet e të gjitha degëve akademike (fakulteteve) të cilët ekzistojnë në BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë.

Emri i organizimit studentor është: **Organizata e Studentëve i BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë.**

Neni 4.

Organizata e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, ka cilësinë e personit juridik.

Organizata e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, ka xhirollogarinë e vet.

Organizata e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, ka vulën e vet katrore dhe atë të rrumbullakët, stemën dhe flamurin.

Më vendim të veçantë të Kuvendit të Organizatës Studentor do të përcaktohet pamja e stemës dhe flamurit, si dhe pamjes dhe përmbajtjes tekstuale të vulës katrore dhe vulës së rrumbullakët.

Neni 5.

Organizatën e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, e përfaqëson dhe prezanton KRYETARI I ORGANIZATËS STUDENTËVE, ndërsa, me lejen e tij NËNKRYETARI dhe/apo SEKRETARI i Organizatës së Studentëve.

Neni 6.

Organizata e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, mund të bashkohet në Federatë të Organizatës Shtetëror të Studentëve, ndërsa, propozimin për bashkim e bien Kryesia e Organizatës së Studentëve, kurse, Kuvendi i Organizatës së Studentëve bie vendimin përfundimtar.

II. QËLLIMET PROGRAMORE

Neni 7.

Qëllimet programore dhe detyrat e Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, janë si më poshtë:

- *pjesëmarrja e studentëve në procesin e krijimit dhe realizimit të programeve të punës të njëjësive akademike (fakulteteve) tek BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, si dhe participimi në organet dhe trupat tjera punuese të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.*
- *afirmimi shkencor, vlera kulturore dhe intelektuale të shoqërisë kosovare, si dhe zhvillimit të gjithanshëm të personalitetit studentor përgjithësisht,*
- *përfshirje e studentëve në rrjedhat jetësore evropiane dhe botërore duke tejkaluar kufizimet gjeografike dhe regjionalizimet, si dhe kyçje të studentëve në të gjitha rrjedhat e zhvillimit dhe ndërtimit bashkohor të Kosovës,*
- *angazhim për lirin shkencore, procesit arsimor dhe edukimit të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, dhe degëve të saja akademike (fakulteteve), si dhe dialogut të hapur me shoqërinë përgjithësisht,*
- *aktivitete permanente në sendërtimin e kushteve optimale sociale dhe shëndetësore dhe sigurimin material, si dhe formimin e kushteve dhe parakushteve për angazhim të profesionistëve të diplomuar akademik në procesin mësimor,*
- *vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellë pune në nivel të gradimeve akademike, punës shkencore dhe kulturore e sportive dhe zbavitëse,*
- *zhvillimin e praktikave feriale në vend dhe jashtë vendit për nevojat e studentëve mbështetur në programet hulumtuese shkencore të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, dhe degëve akademike (fakulteteve) në kuadër të sajë,*
- *organizimin e tribunave, debateve publike, seminareve, simpoziumeve dhe manifestimeve tjera shkencore, kulturore, zbavitëse dhe sportive.*
- *Panë dhe aktivitete tjera më rëndësi për Organizatën e Studentëve.*

III. VEPRIMTARITË

Neni 8.

Organizata e Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, veprimtari themelore ne punën e tij do të këtë, si ne vazhdim:

- prezantimin dhe përfaqësimi e të drejtave dhe interesave të studentëve para organeve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, si dhe institucionet tjera relevante të shtetit,
- përkujdesja për shqetësimet dhe standardin dhe të drejtat e studentëve,
- sendërtimi i bashkëpunimeve të ndërsjella me organizatat tjera studentore, si dhe institucionet relevante hulumtuese shkencore dhe fondacionet,
- organizata studentore mundet ne kuadër te veprimtarisë së vetë dhe qëllimeve të saja programore të themeloj subjekte për çështje të lëmesë ekonomike dhe veprimtarive tjera, nën kushtet paraparë me ligj.

IV. TË DREJTAT, DETYRIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ANËTARËVE

Neni 9.

Anëtar i Organizatës Studentor të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, behët të gjithë student e këtij Kolegji, me regjistrim e tyre në Kolegji, si dhe bërjen e pagesës adekuate në emër të anëtarësimit, pavarësisht gjinisë, racës, përkatësisë nacionale dhe etnike, religjionit, gjuhës, origjinës shoqërore, përkatësisë politike ose suksesit në studime.

Neni 10.

Studentet e BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, të cilët nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjen e Kuvendit Studentor për çfarëdo arsye, mund të paraqesin kërkesë për praninë në Organizatën e Studentëve. Kuvendi i Organizatës Studentor më propozim të Kryesisë se Organizatës Studentor, në seancë të rregullt ose seancë të jashtëzakonshme, do të vendosi lidhur me kërkesën e parashtruar. Seancës së Kuvendit të Organizatës Studentor, ne të cilën do të shqyrtohet dhe do të vendoset për kërkesën e studentit, mund të prezantoj edhe studenti - si parashtrues i kërkesës.

Neni 11.

Anëtar nderi i Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, mundë të jenë edhe profesorët nga vendi dhe jashtë vendit - të cilët me punën e tyre, veprimtarinë dhe ndihmesat materiale dhe teknike kanë ndihmuar në sendërtimin e programeve dhe qëllimeve e detyrave të Organizatës së Studentëve.

Anëtarët e nderit të Organizatës së Studentëve i propozon Kryesia e Organizatës Studentëve, kurse, Kuvendi i Organizatës Studentëve merr vendimin përfundimtar.

Anëtarët e nderit të Organizatës së Studentëve, nuk gëzojnë të drejtën e vendimmarrjes në Organizatën e Studentëve.

Kriteret për anëtarësim nderi të Organizatës së Studentëve, i përcakton Kryesia e Organizatës Studentëve.

Neni 12.

Anëtarët e Organizatës së Studentëve kanë te drejtën e daljes nga Organizata Studentëve.

Anëtarët të cilët dalin nga Organizata Studentëve, ose ata të cilët përjashtohen nga anëtarësimi i Organizatës Studentëve, janë të obliguar që të përmbushin detyrimet e mbetura materiale, ose detyrimeve tjera, kundrejt Organizatës Studentëve.

Neni 13.

Në rast se ndonjë nga anëtarët e Organizatës Studentëve prish qëllimet programore dhe detyrimet e Organizatës Studentëve, apo pengon punën e sajë, atyre u behet vërejtje që veprimet e tyre i harmonizojnë me qëllimet programore dhe detyrimet e Organizatës së Studentëve.

Ne rast se edhe pas dhënies së vërejtjes në formë të shkruar anëtari i Organizatës Studentëve nuk bënë harmonizimin e veprimeve të veta me qëllimet programore dhe detyrimet të Organizatës Studentëve në afat prej tridhjetë (30) ditë, Kryesia e Organizatës Studentëve mund të bëjë thirrjen e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Organizatës Studentëve, në të cilën seancë rasti do të shqyrtohet dhe vis a vis të njëjtit edhe do të vendoset.

Kryesia e Organizatës Studentëve do përgatisë PROPOZIMIN për Kuvendin e Organizatës Studentëve, vendimi i të cilit është përfundimtar.

Neni 14.

Anëtarët e Organizatës Studentëve kanë te drejtën,

- *paraqitjen e mendimeve dhe qëndrimeve si dhe propozimeve të tyre,*
- *inicimin e procedurës për të cilën mendojnë se janë me interes për përmirësimin e standardit të studentëve,*
- *inicimin e procedurës të përgjegjësisë të organeve dhe funksionarëve të Organizatës së Studentëve, si dhe,*
- *sendërtimin në shikimin në punën e organeve të Organizatës së Studentëve – përmes përfaqësuesve të tyre.*

Neni 15.

Anëtarët e Organizatës Studentëve kanë detyrimet,

- *tu përmbahen Statutit dhe akteve tjera normative të Organizatës së Studentëve,*
- *realizimin e qëllimeve dhe detyrimeve e përgjegjësiave të Organizatës së Studentëve,*
- *pjesëmarrje në aksione të përbashkëta.*

V. ORGANET E ORGANIZATËS SË STUDENTËVE

Neni 16.

Organet e Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, janë:

- **KUVENDI I ORGANIZATËS SË STUDENTËVE,**
- **KRYESIA E ORGANIZATËS SË STUDENTËVE, SI DHE**

- **KËSHILLI MBIKËQYRËS I ORGANIZATËS SË STUDENTËVE.**

KUVENDI I ORGANIZATËS SË STUDENTËVE

Neni 17.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, është organi më i lartë i Organizatës së Studentëve, i cili konsituohet pas mbajtjes së zgjedhjeve në BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, si dhe Qendër Studentore.

Kuvendi i Organizatës Studentëve përbëhet nga nga tre (3) anëtar, nga të cilët nga secila degë akademike (fakultet) zgjedhën, ndërsa, nga Qendra e Studentëve zgjidhen dy (2) anëtar.

Kryetari ose Nënkryetari i asociacionit të studentëve të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, zgjidhën si anëtar të kryesisë së Organizatës Studentëve, respektivisht, kryetar, nënkryetar ose sekretar të Organizatës së Studentëve, janë të detyruar të ofrojnë dorëheqjen në postin e kryetarit ose nënkryetarit të Organizatës së Studentëve dhe Qendrës së Studentëve të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë.

Mënyrën dhe procedurën se zgjedhjes, si dhe organin përkatës për zbatim të zgjedhjes se Kuvendit të Organizatës së Studentëve, e ndërmerr dhe cakton Kryesia e Kuvendit të Organizatës së Studentëve.

Kuvendi në seancën zgjedhore bënë verifikimin e anëtarëve të sajë.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve mund të punoi dhe vendosi nëse në seancë marrin pjesë mbi 50% e anëtarëve të Kuvendit të Organizatës Studentëve.

Të gjitha vendimet e Kuvendit të Organizatës Studentëve merrem me vota të 2/3 të anëtarëve prezent në seancë të Kuvendit të Organizatës së Studentëve.

Neni 18.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve mblidhet ne seanca te rregullta dhe seanca te jashtëzakonshme.

Seancat e rregullta të Kuvendit të Organizatës së Studentëve mbahen se paku në çdo gjashtë (6) muaj, ndërsa, seancat e jashtëzakonshme mbahen sipas nevojës.

Kuvendin e Organizatës së Studentëve e thirret Kryetari i Kuvendit me kërkesë:

- *Kryesisë,*
- *Këshillit Mbikëqyrës,*
- *se paku një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit.*

Nga dita e thirrjes deri ditën e mbajtjes së seancës se Kuvendit të Organizatës së Studentëve duhet kaluar se paku pesë (5) ditë.

Ftuesi i seancës është i obliguar të propozoi RENDIN E DITËS dhe siguroi materialin e nevojshëm.

Neni 19.

Vendime e Kuvendit të Organizatës së Studentëve me dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Kuvendit të Organizatës së Studentëve prezent ne seancë, në kuadër të kompetencave, si me poshtë:

- miraton Statutin të Organizatës së Studentëve, si dhe ndryshim plotësimin e Statutit,
- vërteton politikën dhe programet zhvillimore të Organizatës së Studentëve,
- konfirmon programet vjetore dhe ato afatgjate te punës së Organizatës së Studentëve,
- vendos mbi pranimin e anëtarëve riinjë dhe ndërprerjes së anëtarësimit të Organizatës së Studentëve,
- vendos për anëtarësim të Organizatës së Studentëve në organe ndërkombëtare dhe asociacione tjera,
- zgjedhë dhe shkarkon anëtarët e organeve të Organizatës së Studentëve, si dhe komplet organet e Organizatës së Studentëve,
- miraton Rregulloren mbi Punën e Kuvendit të Organizatës së Studentëve,
- vendos mbi ndërrimin e emrit të Organizatës së Studentëve,
- shqyrton raportet financiare të Organizatës së Studentëve.

Neni 20.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve mund të votoi besueshmërinë të gjitha organeve të Organizatës së Studentëve, nëse nuk përmbushin detyrimet dhe punët e besuara.

Besueshmëria votohet me dy të tretat (2/3) e anëtarëve prezent në seancë.

KRYESIA E ORGANIZATËS SË STUDENËVE

Neni 21.

Kryesia e Organizatës së Studentëve është organ ekzekutiv i Organizatës së Studentëve, të cilin e përbëjnë:

- Kryetari,
- Nënkryetari,
- Sekretari,
- anëtarët e Kryesisë, nga të cilët: nga një (1) anëtar nga njësit akademike (fakultet) dhe një (1) nga Qendra e Studentëve.

Propozimin për anëtar të Kryesisë të Organizatës së Studentëve japin anëtarët e Kuvendit të Organizatës së Studentëve nga një (1) anëtarë për secilën njësi akademike (fakultet), respektivisht, një (1) anëtar nga Qendra e Studentëve.

Me zgjedhjen e anëtarit të Kryesisë se Organizatës së Studentëve ndërpriten anëtarësimi në Kuvendin e Organizatës së Studentëve.

Vendet e lira në Kuvendin e Organizatës së Studentëve plotësohen në formën që anëtar i Kuvendit të Organizatës së Studentëve behet kandidati i cili gjendet në Regjistër për Kuvend të Organizatës së Studentëve pas studentit i cili është i zgjedhur si anëtar i Kryesisë së Organizatës së Studentëve.

Kuvendi bënë verifikimin e anëtarëve të propozuar për anëtar të Kryesisë të Organizatës së Studentëve në seancën zgjedhore.

Mandati i anëtarëve të Kryesisë të Organizatës së Studentëve zgjatë dy (2) vjet.

Mandati i anëtarëve të Kryesisë së Organizatës së Studentëve pushon me kalimin e mandatit, dorëheqje dhe shkarkim.

Kryesisë e Organizatës së Studentëve punon ne seanca secilën prezantojnë dy te tretat (2/3) e anëtarëve.

Kryesia e Organizatës së Studentëve mblidhet se paku një herë në çdo pesëmbëdhjetë (15) ditë.

Më punën e Kryesisë të Organizatës së Studentëve udhëheqë Kryetari i Organizatës së Studentëve.

Neni 22.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve ne seancën zgjedhore me dy te tretat (2/3) e anëtarëve prezent zgjedh Kryetarin e Organizatës së Studentëve, Nënkyetarin dhe anëtarët e tjerw tw pwrcaktuar nga Kuvendi i Organizatës Studentëve.

Kryetari dhe Nënkyetari i Organizatës së Studentëve nuk mund të vijnë nga e njëjta njësi akademike (fakultet).

Sekretarin e Organizatës së Studentëve e zgjedhë Kryesia e Organizatës së Studentëve në bazë të konkursit të publikuar në BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë.

Kushtet për konkurs i definojnë Kryesia e Organizatës së Studentëve.

Pa zgjedhjes së Sekretarit të Organizatës së Studentëve, Sekretari merr pjesë ne seancat e Kryesisë të Organizatës së Studentëve me të drejtë vote.

Kuvendi i Organizatës së Studentëve në seancën e rregullt ose atë të jashtëzakonshme, mund të votoj mosbesimin e Kryesuesit dhe Nën Kryesuesit të Organizatës së Studentëve, si dhe Sekretarit, nëse ata nuk përmbushin punët dhe detyrat e tyre.

Mosbesimi konsiderohet i votuar nëse votojnë dy te tretat (2/3) e votave të anëtarëve prezent të Kuvendit të Organizatës së Studentëve.

Neni 23.

Kryesia e Organizatës së Studentëve kryen këto punë:

- *zbaton vendimet e Kuvendit të Organizatës së Studentëve,*
- *zgjedhe dhe shkarkon Sekretarin e Organizatës së Studentëve,*
- *propozon miratimin e akteve të përgjithshme normative qe janë në kompetencë të Kuvendit të Organizatës së Studentëve,*

- *propozon miratimin e programeve konkrete pune,*
- *miraton rregulloren e punës të Kryesisë të Organizatës së Studentëve,*
- *jep interpretime të akteve normative të cilat i miraton,*
- *emëron përfaqësuesit e Organizatës së Studentëve në Senat, Këshill drejtues dhe organe tjera të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë,*
- *verifikon mandatet e përfaqësuesve të studentëve në shoqata të studentëve të fakulteteve dhe këshilla shkencore arsimore të fakulteteve,*
- *sendërton mbikëqyrjen në punën e shoqatave studentëve që veprojnë në kuadër të të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë,*
- *sendërton politikat e verifikuara dhe programet e zhvillimit të Organizatës së Studentëve,*
- *emëron trupa të përhershme dhe të përkohshme për kryerjen e detyrimeve të Organizatës së Studentëve,*
- *kryen edhe punë e detyra tjera.*

Neni 24.

Kryesia e Organizatës së Studentëve është i obliguar që Kuvendit të Organizatës së Studentëve që të prezantoj raportin e punës, afarizmi material dhe financiar të Organizatës së Studentëve.

KËSHILLI MBIKËQYRËS

Neni 25.

Këshillin Mbikëqyrës bënë kontrollin e ligjshmërisë në punë dhe afarizmit financiar të Organizatës Studentëve.

Këshillin Mbikëqyrës përbehet nga një (1) anëtar për secilën njësi akademike (fakultet) dhe një (1) anëtar nga Kuvendi i Organizatës së Studentëve.

Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës bëhet në procedurë të njëjtë sikur zgjedhja e anëtarëve të kryesisë të Organizatës së Studentëve.

Këshilli Mbikëqyrës nga radhe e veta zgjedh Kryesuesin e Këshillit Mbikëqyrës.

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës nuk guxojnë të jenë anëtar të Kryesisë të Organizatës së Studentëve.

Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Organizatës së Studentëve zgjatë dy (2) vjet.

Në rast ndërprerje të mandatit të anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës, Kuvendi i Organizatës Studentëve është i obliguar të inicioj procedurën e zgjedhjes të anëtarëve të RI në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

V. KRYETARI I ORGANIZATËS STUDENTËVE

Neni 26.

Kryetarin e Organizatës së Studentëve e zgjedh Kuvendi i Organizatës Studentëve me dy të tretat (2/3) e shumicës së anëtarëve në seancës e sajë të parë zgjedhore nga radha e anëtarëve të sajë.

Me zgjedhjen ne postin e Kryetarin e Organizatës Studentëve ndërpritet anëtarësimi në Kuvendin e Organizatës Studentëve.

Mandati i Kryetarit të Organizatës Studentëve zgjatë dy (2) vjet.

Mandati i Kryetarit të Organizatës Studentëve ndërpritet me kalimin e afatit, dorëheqje dhe shkarkim.

Neni 27.

Të drejtat dhe detyrimet e Kryetarit të Organizatës Studentëve janë:

- përfaqëson Organizatën e Studentëve ne vend dhe jashtë vendit,
- konvokimin, përfaqësimin dhe pjesëmarrjen në punën dhe vendosjen ne seanca të Kryesisë të Organizatës Studentëve,
- nënshkrimin e të gjitha akteve dhe dokumenteve tjera të shkruara qe kanë të bëjnë me afarizmin e Organizatës Studentëve,
- përfaqësimin e Organizatës Studentëve ne media,
- përfaqësimin e Organizatës Studentëve në kontaktet me organizata tjera,
- posedimin dhe përdorimin e vulave të Organizatës Studentëve,
- disponimin e pavarur të mjeteve financiare të Organizatës Studentëve në shumën prej _____ € për nevojat e Organizatës Studentëve.

Neni 28.

Autorizimet e Kryetarit të Organizatës Studentëve, në rast të mungesës së tij, pengimit ose përfundimit të mandatit para kohe, kalojnë tek Nënkryetari i Organizatës Studentëve.

Kryetari i Organizatës Studentëve mund të shkarkohet nga funksioni nëse nuk përmbush detyrat e punës dhe nuk mbështet parimet bazë të Organizatës Studentëve.

Kryetarin e Organizatës Studentëve me propozim të Këshillit Mbikëqyrës të Organizatës Studentëve ose një të tretës (1/3) se anëtarëve të Kuvendit të Organizatës Studentëve, e shkarkon Kuvendi i Organizatës Studentëve me dy të tretat (2/3) e shumicës të anëtarëve prezent.

Nëse Kryetarit të Organizatës Studentëve i ndërpritet mandati, Kuvendi i Organizatës Studentëve është i detyruar qe të inicioj procedurën e zgjedhjes së Kryetarit të Organizatës Studentëve në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

VI. NËNKRYETARI I ORGANIZATËS STUDENTËVE

Neni 29.

Zgjedhja e Nënkyetarit të Organizatës Studentëve behet nga anëtarët e Kuvendit të Organizatës Studentëve, me princip të njëjtë si edhe zgjedhja e Kryetarit të Organizatës Studentëve.

Me zgjedhjen e Nënkyetarit të Organizatës Studentëve pushon anëtarësimi ne kuvendin e Organizatës Studentëve.

Mandati i Nënkyetarit të Organizatës Studentëve zgjatë dy (2) vjet.

Mandati i Nënkyetarit të Organizatës Studentëve ndërpritet me kalimin e afatit, dorëheqje dhe shkarkim.

Neni 30.

Të drejtat si dhe detyrimet e Nënkyetarit të Organizatës Studentëve janë:

- *zëvendësim të Kryetarit të Organizatës Studentëve me të gjitha të drejtat dhe detyrimet ne rast të mungesës se tij, pengimit në ushtrimin e detyrimeve dhe punëve ose më marrëveshje të ndërsjellë,*
- *Nënkyetari i Organizatës Studentëve mund të ushtroi punët dhe detyrimet e Kryetarit të Organizatës Studentëve vetëm nëse jepet autorizim përpiluar në formë të shkruar.*

VII. SEKRETARI I ORGANIZATËS STUDENTËVE

Neni 31.

Sekretarin e Organizatës Studentëve zgjedhe Kryesia e Organizatës Studentëve ne bazë të konkursit publikuar ndërmjet studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë.

Kushtet për konkurs i përcakton Kryesia e Organizatës Studentëve

Mandati i Sekretarit të Organizatës Studentëve zgjatë dy (2) vjet.

Mandati i Sekretarit të Organizatës Studentëve ndërpritet me kalimin e afatit, dorëheqje dhe shkarkim.

Neni 32.

Të drejtat dhe detyrimet e Sekretarit të Organizatës Studentëve, janë:

- *përbushje e punëve ekzekutuese,*
- *përgatitjen e materialeve për seanca dhe mbledhje,*
- *pjesëmarrja në punën e Kryesisë të Organizatës Studentëve,*
- *mbajtjes se procesverbaleve dhe protokollit të Organizatës Studentëve,*
- *punë dhe detyra tjera qe i ndan Kryesia e Organizatës Studentëve,*
- *posedim dhe përdorim të vulave të Organizatës Studentëve.*

VIII. PUNA PUBLIKE E ORGANIZATËS STUDENTËVE

Neni 33.

Puna e Organizatës Studentëve, organeve të sajë dhe trupave punuese është publik.

Puna publike sendërtohet me mbajtjen e mbledhjeve dhe seancave publike, njoftimeve të përhershme ose kohë pas kohe ne publik lidhur me tematikat aktuale të Organizatës Studentëve.

Përrjashtimisht, seancat dhe mbledhjet e organeve dhe trupave punuese në kuadër të Organizatës Studentëve, mund të jenë të mbyllura për publik, dhe ne rastet e tilla pas mbajtjes se seancave dhe mbledhjeve do të jepet njoftim publik.

Neni 34.

Përrjashtimisht fshehtësitë afarist nuk do ti kumtohen publikut.

Fshehtësi afariste përbëjnë dokumentet dhe shënimet publikimi i të cilave personave të paautorizuar do të ishte në kundërshtim me parimet e afarizmit të Organizatës Studentëve, dhe kështu do ti shkaktohej dëm interesave dhe reputacionit e prestigjit të Organizatës Studentëve.

Anëtarët e Organizatës Studentëve të BPrAL Kolegji "UBT-e" sh.p.k., Prishtinë, janë të detyruar dhe bartin përrgjegjësinë për ruajtjen e fshehtësisë afariste.

IX. AFARIZMI FINANCIARE MATERIAL I ORGANIZATËS STUDENTËVE

Neni 35.

Afarizmi financiar material i Organizatës Studentëve behet ne përrputhje me Ligjin dhe i njëjti i nënshtrohet kontrollit të Organizatës Studentëve.

Planin Financiar e miraton Kryesia e Organizatës Studentëve.

Neni 36.

Mjetet financiare të Organizatës Studentëve realizohet, si ne vazhdim:

- *anëtarësisë,*
- *dhuratave dhe donacioneve,*
- *të hyrave tjera.*

Shuma, qëllimet dhe shpërrndarjet e mjeteve financiare verifikohet me Plan Financiar për çdo vit kalendarik. Shikimi në disponimin e mjeteve financiare të Organizatës Studentëve, sipas Planit Ekzistues Financiar, kanë Kryetari dhe Sekretari i Organizatës Studentëve.

X. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRRFUNDIMTARE

Neni 37.

Ndryshim - plotësimet e Statutit të Organizatës Studentëve kryhen në procedurë qe Statuti është miratuar.

Ndryshim - plotësimet e Statutit të Organizatës Studentëve mund ti propozoi:

- *Kryesia e Organizatës Studentëve, si dhe*
- *se paku një e treta (1/3) e anëtarëve të Kuvendit të Organizatës Studentëve.*

Neni 38.

Në rast të pushimit të punës të Organizatës Studentëve të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, Kuvendi i Organizatës Studentëve do të vendosi se çka do bëhet me pasurinë e ORGANIZATËS STUDENTËVE.

Neni 39.

Ky Statut i Organizatës Studentëve të BPrAL Kolegji “UBT-e” sh.p.k., Prishtinë, hynë në fuqi ditën e miratimit dhe nënshkrimit të tij nga Kuvendi i Organizatës Studentëve.

PRISHTINË,
Datë, 15.05.2019

KRYETARI I ORGANIZATËS STUDENTOR,
